

FJALA E DEPUTETES ANILA DENAJ

E ENJTE 21 PRILL 2022

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë, qytetarë dhe biznese,

Në fakt, nevoja për këtë ligj ka lindur më herët, nuk është vetëm një nevojë e situatës së momentit dhe e nevojës së vetë biznesit për mbështetje. Kjo nevojë ka lindur më herët, sikurse e tha edhe kolegja zonja Ekonomi, pasi ka pasur shumë mbështetje, por nuk kanë qenë të koordinuara në një aktivitet dhe në një institucion që t'i mbikëqyrë, t'i monitorojë, aq më tepër t'i bëjë transparente të gjitha përfitimet. Cilat janë disa nga format e mbështetjes të qeverisë shqiptare, të cilat, sidomos në 4 vjetët e fundit, kanë qenë të theksuara? Sigurisht, është ajo tradicionalja nëpërmjet ndihmës shtetërore nga buxheti i shtetit.

Ka një mbështetje të theksuar sidomos për sektorin e bujqësisë dhe të turizmit nga donatorë të ndryshëm. Dua të përmend këtu pjesën e BERZH-it për bujqësinë, të cilën zonja Milva Ekonomi e di, që iu shtua edhe pjesa e turizmit për aksesin në financë me një total prej gati 180 milionë eurosh edhe me mbështetjen e qeverisë shqiptare; kemi KfW-në me fonde, të cilat janë me Agro-n, por janë edhe me startup-in; kemi donatorë të tjerë, të cilët lehtësojnë aksesin në financë dhe mundësojnë që përfitueshmëria e bizneseve të jetë me norma më të ulëta interesi dhe me kolateral të reduktuar pikërisht se është kjo garanci që jep edhe donatori, edhe shteti në participim. Forma e tretë është garancia shtetërore, ajo e garancive sovrane, që jo vetëm gjatë pandemisë ishin njëra pas tjetrës, por janë edhe garanci të tjera për sektorin e turizmit që janë lançuar edhe në programin e qeverisë "Rama" edhe në sektorë të tjerë, sidomos në atë të digjitalizimit, sepse nevoja është për të automatizuar.

I përmendi pak më parë kolegja, janë edhe shërbimet publike për ndërmarrjet mikro, të vogla e të mesme, që lidhen kryesisht me shërbime në përditshmërinë e tyre. Nuk ka pasur një dorë, e cila mund ta organizojë këtë operacion, ta monitorojë dhe ta bëjë atë të qartë për publikun. AIDA është agjencia, e cila do të ketë detyrimin për t'i administruar nëpërmjet një portali elektronik për instrumentet financiare të krijuara me fonde nga buxheti i shtetit dhe me donatorët. Për çfarë shifrash flasim, jo vetëm në kontekstin buxhetor, por, në radhë të parë, çfarë përfaqësimi kanë biznesi i vogël dhe i mesëm në totalitetin e strukturës së biznesit? Po sjell vetëm 4 shifra: 99% e ndërmarrjeve në Shqipëri, me statistikën e vitit 2020, janë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, me karakteristikat që zonja ministre i tha pak më parë, me të paktën deri në 250 punonjës dhe me qarkullim deri në 250 milionë xhiro në vit; 80% e të punësuarve në të gjithë strukturën e të punësuarve vijnë nga SMja; 79% e shitjes neto dhe 74% e investimeve realizohet nga këto ndërmarrje.

Ne po flasim për atë që është shtylla kurrizore e të gjithë strukturës së bizneseve. Është shumë e domosdoshme që kjo ndihmë të vijë e koordinuar dhe si nevojë e momentit. Çfarë është e nevojshme sot? Sot ka nevojë për të bërë studime që i ndihmojnë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme për të

adaptuar ndryshimet qoftë në teknologji apo nevojat e tjera që sjell koha dhe të jenë të orientuara jo vetëm nëpërmjet investimeve apo akseseve në financë, por edhe granteve. Të gjitha planet e mbështetjes buxhetore nëpërmjet këtij projektligji parashikojnë një fond gati 50 milionë lekë në vit për pjesën e grantit, por edhe një fond që shkon 1,5 milionë deri në 3 milionë nga një vit tek tjetri për pjesën e trajnimit.

Së dyti, për artizanatin ne kemi një pasuri nga Veriu në Jug të Shqipërisë, nga Lindja në Perëndim, ku të gjitha zonjat dhe zotërinjtë që jo vetëm e kanë trashëguar nga familja e tyre, por edhe mund ta kenë të mësuar atë punë, e cila jo domosdoshmërisht është punëdore. Po të shkoni në Gjermani, e shikoni se ai që quhet artizanat, është me teknologjinë më të fundit të kohës, por ka në thelb traditën dhe vlerën e atij që është produkti “Made in Albania”, sikurse janë edhe nevojat për të rritur inovacionin dhe për të zhvilluar teknologjinë. Fondi i zhvillimit të ndërmarrjeve nga agjencia AIDA nuk ka munguar. Zonja ministre tha pak më parë 90 raste. Në total mund të jenë 300, i referohemi një viti, por unë gjithmonë do ta ktheja këtë diskutim edhe në një pyetje shumë konkrete: a e dinë bizneset e vogla dhe të mesme se cilat janë kriteret për të marrë këto fonde?

A ka një transparencë se cilat janë ndërmarrjet që kanë marrë këto fonde? Kjo është absolutisht e nevojshme dhe nuk e përcakton ky projektligj, por rregullat, që duhet të vendosen me vendim të Këshillit të Ministrave, duhet të jenë të qarta që AIDA duhet të nxisë nëpërmjet platformës qoftë elektronike apo të promovimit, se instrumentet dhe strukturat i ka, jo vetëm ndërmarrjet e vogla për të aplikuar, por të bëjë transparencë dhe ta bëjë atë të plotë, të përhershme, të përmuajshme. Qeveria i ka dhënë rol Këshillit Konsultativ, ku janë 11 anëtarë (ne në Komisionin e Ekonomisë e ulëm nga 18 në 11, se menduam që një numër prej 11 persona është më efektiv, ku ka përfaqësues si nga biznesi, ashtu edhe nga institucionet ligjzbatuese, të përfaqësuar nga ministrinë përkatëse, nga dhomat e biznesit, nga Shoqata e bankave, nga arsimi jopublik dhe ai publik). Nevoja është që ky këshillim të jetë jo vetëm në vëmendje për të dhënë ndihmën, grantet për SME-të, por edhe për t'i ndryshuar ato kriteret, të cilat mund të jenë më adekuate sipas nevojës.

Së fundi, dua të them që për ndërmarrjet e vogla e të mesme investimi prej 50 milionë lekësh në vit nuk është një shumë e madhe, por nuk është e vetmja, dhe nevoja e kombinimit të granteve me aksesin në financë është e domosdoshme. Të gjitha bankat e nivelit të dytë, ose pjesa më e madhe e tyre kanë akses në sistemin e granteve, të donacioneve apo të mbështetjes që ka dhënë dhe japin qeveria shqiptare dhe donatorët e tjerë, por a ka një vëzhgim nëse kanë shkuar te ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, pra atje ku duhet? A ka shkuar me një normë interesi më të reduktuar sesa normat bazë për çdo klienti? A ka rritur efektivitetin në kolateral? Unë jam shumë shpresëplotë që AIDA do ta realizojë këtë funksion.

Marrëdhënia edhe me Komisionin e Ekonomisë, nëpërmjet ministrisë përgjegjëse, do të jetë e tillë që edhe në Kuvend duhet rritur llogaridhënia, në mënyrë që të kemi të gjithë një qartësi se ku janë përdorur këto grante dhe çfarë kanë realizuar në fund të ditës? Sepse, nëse nuk rritet konkurrueshmëria, nuk rritet vlera dhe nuk rritet numri i të punësuarve, atëherë jo 50 milionë, por dhe 500 milionë të japim, nuk do të ishte efektive. Megjithatë, unë jam e bindur që ky ligj, për sa kohë ka munguar organizimi i të gjitha këtyre instrumenteve në një dorë të vetme dhe me një institucion në

varësi të Ministrisë së Financave dhe me rregulla të qarta nga Këshilli i Ministrave, do t'ia arrijë këtij qëllimi dhe llogaridhënia në Kuvendin e Shqipërisë, sipas rregullave dhe ligjeve të përcaktuara, do të mundësojë edhe një transparencë më të madhe. Shumë faleminderit!